

---

ANALIZË

---

# *Qysh me e mat kulturën?*

---

Tetorë 2015, Prishtinë



**FORUMI  
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura

Rrjeti i organizatave të pavarura të  
kulturës të Kosovës

[www.forumikulturor.net](http://www.forumikulturor.net)





**FORUMI  
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës  
[www.forumikulturor.net](http://www.forumikulturor.net)

Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme International Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.

*“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian dhe Olof Palme International Center”*

---

ANALIZË

---

# Qysh me e mat kulturën?



Projekt i financuar nga BE-ja  
dhe i menaxhuar nga Zyra e  
Bashkimit Evropian në Kosovë



SWEDEN

# Hyrje

Shumë herë është thënë tashmë se kultura matet me cilësi e jo me sasi. Kjo thënie do të ishte e pakontestueshme, deri në momentin kur statistikat kuantitative për kulturën megjithatë nuk mbesin krejtësisht të parëndësishme. Pra, askush nuk mund ta mohojë se kulturën e mban gjallë kualiteti, por tek e fundit ajo prodhohet për njerëzit. Çështja është si të matet kultura!?

Kosova, fatkeqësisht, në këto 16 vjet pasluftës ende nuk ka arritur të krijojë mekanizma të qëndrueshëm e seriozë të matjes së përgjithshme të prodhimit kulturor në vend. Agjencia e Statistikave e Kosovës, për 9 vjet rresht bën matjen e kulturës, në atë që e quan si “Statistikat për Kulturën”. Puna e kësaj Agjencie është në thelb të këtij punimi, teksa do të mund të shihni një analizë më të detajuar të raportit të fundit të publikuar nga ky institucion, ai i statistikave të vitit 2013. Ajo çka vërehet në leximin e të gjithë raporteve, është shablloni të cilin e ka krijuar ky raportim prej të cilit duket të jetë zor të dilet. Raporti mund të konsiderohet i mangët për shumë arsye.

Statistikat e mirëfillta kulturore do të

duhej të nxirrnin, ndër të tjera, edhe të dhëna për orientimet e shijes së publikut. Mbi këtë bazë më tej do të duhej të orientoheshin investimet shtetërore për kulturën. Duke mos pasur vullnet për të krijuar këso statistika, buxheti i paracaktuar për përkrahjen e kulturës shpërndahet sipas qejfeve të prijësve politikë të kulturës.

Pas shumë vjetësh përpjekje një Data-bazë për trashëgiminë kulturore, me gabime dhe e mangët, në mënyrë elektronike është lansuar në vitin 2014. Megjithatë askush nuk e mat numrin e vizitorëve nëpër sitet e trashëgimisë kulturore të Kosovës, përfshirë edhe ato kryesoret e më të vizituarat si Kallaja e Prizrenit, Ulpiana apo ndonjë tjetër.

Pra, statistikat kulturore nuk janë vetëm numri i vizitorëve nëpër institucionet të kulturës, numri kapaciteteve formale të të njëjtave apo i njerëzve që punojnë aty. Siç do të shohim në këtë raport të shkurtër, ato janë shumë më shumë.

# 1. Shembuj nga bota (Çka nuk bën Kosova!)

I. Dimensioni më i rëndësishëm për kulturën është konsumi i saj. Nuk vlen libri që s'ka lexues, teatri e filmi pa shikues, muzeu e galeria pa vizitorë...

Kosova aspiron integrimin në Bashkimin Evropian. Por në mesin e shumë punëve që duhen kryer janë edhe mbledhja e statistikave të kulturës, siç e bën "Eurostatin".

Shembull i përfaqësimit të shtetit në statistikat evropiane të kulturës është edicioni i 2011-ës, "Eurostat Pocketbook – Cultural Statistics", që paraqet statistika për vendet e BE-së, vendet kandidate për anëtarësim dhe ato jashtë BE-së (Islanda, Lituania, Norvegjia dhe Zvicra).

Kapitulli i parë i dedikohet "Të dhënave ekonomike dhe sociale". Aty pasqyrohen tabelat për "Popullsinë, GDP-në për kokë banori dhe popullsinë në rrezik nga varfëria". Pjesë e kapitullit janë edhe detaje të popullsisë, si moshë prej 0-24 vjet dhe projeksionet e kësaj moshë deri në vitin 2030, shpërndarja e popullsisë sipas shkallës së urbanizimit, emigrantët, niveli i edukimit në krahasim me grupmoshën, gjinisë, aktiviteti dhe nivelet e punësimit sip-

as gjinisë, si dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe edukimit. [Eurostat Pocketbook – Cultural Statistics, 2011, fq. 13 – 221]. Krejt këto detaje dalin të jenë të vlefshme për statistikat kulturore, sado që në dukje të parë mund të mos tingëllojnë si të tilla. Niveli i edukimit por edhe i ekonomisë kanë rol thelbësor në pjesëmarrjen në aktivitete të kulturës.

Në anën tjetër, shembulli mund të ndiqet edhe nga "Compendium of Cultural Policies and Trends in Europe", projekti që nisi më shumë se 15 vjet më parë, nga Këshilli i Evropës, e që është një uebfaqe që grumbullon informacione të përditësuar e të përhershme dhe monitoron politikat kulturore kombëtare në Evropë. Ai është një projekt afatgjatë i cili synon të përfshijë të 50 shtetet anëtare që të bashkëpunojnë në kuadër të Konventës Kulturore Evropiane. [culturalpolicies.net2].

Aty, matja e pjesëmarrjes së të rriturve

1 <http://ec.europa.eu/eurostat/documents/3930297/5967138/KS-32-10-374-EN.PDF/07591da7-d016-4065-9676-27386f900857?version=1.0>

2 <http://www.culturalpolicies.net/web/index.php>

në aktivitete kulturore në periudhën 12 mujore tregon se duhet të gjenerohen saktë statistika për nivelin e edukimit të participantëve, për gjininë dhe moshën e tyre<sup>3</sup>. Dhe kjo, në fakt, është një e dhënë fare elementare, të cilën Kosova nuk e ka. Por përtej kësaj, ajo që del të jetë e nevojshme në këtë kontekst është një lloj “indeksi kulturor” i cili do të gjeneronte të dhëna për shprehitë kulturore të qytetarëve të Kosovës. Një prej metodave do të mund të ishte përfshirja e pyetjeve që matin shprehitë kulturore (leximi i librave, gazetave e revistave, vizita në kinema, teatër, koncerte, muze, galeri, e institucione të tjera të kulturës), ose në kuadër të projekteve të më të gjera të matjes së opinionit publik, ose si e veçantë. Shumë çështje të tjera, përfshirë edhe shijet e publikut për produktet kulturore mund të dilnin më pas si pjesë e “indeksit”.

II. Raporti i Eurostatit për “Statistikat kulturore”, kapitullin e dytë ia dedikon trashëgimisë kulturore. Aty ka të renditura të gjithë sitet e trashëgimisë kulturore e natyrore që ndodhen në

vendet që i ka target, e të cilat kanë vulën e mbrojtjes nga UNESCO<sup>4</sup>. Pjesë e statistikave është edhe renditja e pesë muzeve më të vizituar në secilin nga shtetet anëtare të BE-së, ajo jashtë saj, dhe vendet candidate (numri i vizitorëve për vitin 2009). Numri i vizitorëve në total i pesë muzeve, në pothuajse të gjitha vendet e BE-së, është sa numri i banorëve të Kosovës. P.sh. në Belgjikë në pesë muze në vitin 2009, kanë vizituar 1,8 milion, në Çeki, 2,1 milionë, etj. Franca, përfshirë Muzeun e Luvrit (më shumë se 8 milionë), në vitin 2009 në pesë muze ka pasur më shumë se 22 milionë vizitorë. Kroacia fqinje, ka pasur në pesë muze të saj më të vizituar në vitin 2009, më shumë se 1,3 milion vizitorë. Përkundër përpjekjeve të shumicës së garniturave politike të pasluftës që kanë drejtuar Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për të hartuar Ligjin e Veçantë për Muzetë, një gjë e tillë ende nuk është bërë. Prandaj, përveç rregullimit të statutit të muzeve, mungojnë edhe statistikat e sakta për num-

4 <http://ec.europa.eu/eurostat/documents/3930297/5967138/KS-32-10-374-EN.PDF/07591da7-d016-4065-9676-27386f900857?version=1.0>

3 <http://www.culturalpolicies.net/web/statistics-participation.php>

rin e muzeve, numrin e vizitorëve në to dhe numrin e artefakteve. Pra, shteti nuk ka ende një numër të saktë të artefakteve arkeologjike e etnologjike që i posedon. Zyrtarisht, Kosova ka 1243 artefakte në Beograd, të cilat u morën nga Muzeu i Kosovës, teksa Serbia po tërhiqej me ushtri e administratë në vitin 1999. Ndërkohë, shumë artefakte të vlefshme arkeologjike e etnologjike ruhen nëpër objekte shkollash apo institucione të kulturës, të cilat janë mbledhur kryesisht nga profesorët e historisë, gjeografisë, sociologjisë apo të tjerë profile që ua dinë rëndësinë atyre. Megjithatë ato presin inventarizimin dhe trajtimin adekuat. Shumë artefakte të tjera, tejet të vlefshme, mbesin nëpër zyrat e arkeologëve të cilat përgjatë gjurmëve i zbuluan ato. Pafund raste ka kur njerëzit i ruajnë në shtëpitë e tyre artefakte, monedha të moçme, apo artefakte etnologjike që i gjetën ose gjatë punimit të tokës ose i ruajnë si pjesë të traditës së tyre. Kosova nuk ka ende një Listë të Përhershme për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, dhe shkaqet për këtë janë kryesisht të mungesës së vullnetit politik. Tri herë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka freskuar Listën

e Përkohshme për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, e cila ka fiks 1441 objekte. Ndërkohë, MKRS-së i ishin dashur 6 vjet punë, që me rreth 200 mijë euro donacion nga Ambasada Britanike në Kosovë të lansojë Databazën elektronike për Trashëgimi Kulturor<sup>5</sup>. Ajo ishte lëshuar në qarkullim në korrik të 2014-s. Gabimet aty ishin të shumta.

“As pas zvarritjes gjashtëvjeçare, MKRS-ja nuk ka arritur të evitohet gabimet. Pos që janë përfshirë jo më shumë se 265 asete, në disa mungojnë fotografitë, e disa ilustrohen me foto të dobëta. Diku ka mungesë shënimesh dhe përzjerje të të dhënave midis versioneve tregjuhëshe, përderisa vërehen edhe vërejtjet për përmirësim gabimesh” [Koha Ditore, 16 korrik 2014, fq 26]. “Ka qenë dhjetori i 2008-s kur ish-ministri i Kulturës, Valton Beqiri, bashkë me ambasadorin e atëhershëm të Britanisë së Madhe në Prishtinë, Andy Sparks, kishin regjistruar “Hyjneshën në fron” si eksponatin që do t’i paraprinte digjitalizimit të të dhënave për objektet dhe eksponatet e tjera të trashëgimisë kulturore... “Hyjnesha...” që u regjistrua e para, nuk është aty.

<sup>5</sup> <http://dtk.rks-gov.net/>

Përfshinë 185 arkitektonike, 52 lokalitete arkeologjike dhe 30 të luajshmë, përderisa Lista e monumenteve nën mbrojtje të përkohshme ka 1426 asete”. [Po aty]

Në Fokus Grupin që është mbajtur në qershor të vitit 2015, me qëllim të validimit të të dhënave të dala nga analiza e shkurtër, Sali Shoshi, drejtor i degës në Kosovë i organizatës suedeze “Trashëgimia Kulturore pa Kufij”, ka folur për këtë projekt, në të cilin vet ka qenë i përfshirë.

“Kur e kemi filluar projektin, nga MKRS-ja na është thënë se i kanë të gjitha të dhënat, por u mungon mekanizmi, formati digjital. Ne në bashkëpunim me Ambasadën Britanike e kemi punuar, me ç’rast u pat blerë ‘një kamion’ hardvera të cilat janë dërguar në bodrum të MKRS. Si shembull, në formatin DataIndex i cili i kërkon 50 informata, në rastin më të mirë është arritur që të sigurohen vetëm 11 informata të cilat i ka poseduar MKRS, e edhe ato informata kanë qenë të pa verifikuara”, ka thënë Shoshi në Fokus Grup. “Për shembull, për një objekt është thënë që daton nga shekulli XVII-XVIII, ku

hapësira e datës së saktë është 200 vjet. Përgjegjësia nuk është marrë nga asnjë punonjës i MKRS, dhe kjo situatë vazhdon nga viti 2009. Tash e një vit asnjë informatë nuk është përditësuar në këtë Databazë, përfshirë fjalinë e Ministrit dhe fotografinë e tij (edhe pse Ministri është ndërruar)”, ka shtuar më tej ai.

III. Çështje tjetër që matet me statistika të kulturës është numri i të punësuarve në prodhimin kulturor. Ky është proces i komplikuar dhe aspak i lehtë.

Pra në njërën anë janë punonjësit për prodhimin kulturor, që jo domosdoshmërisht hyjnë në mesin e personave kreativë të prodhimit kulturor si arkivistët, bibliotekarët, stafi teknik në teatër, kinema, galeri, muze, e të tjerë si dhe në anën tjetër janë krijuesit që jo domosdo kanë një vend pune me kontratë si, shkrimtarët, aktorët, skulptorët, piktorët, kompozitorët, muzikantët, këngëtarët, koreografët, valltarët, regjisorët dhe artistë të tjerë të ngjashëm.

Definimin e saktë të këtyre çështjeve e ka zgjidhur “ESSnet-CULTURE” (European Statistical System Network on



Culture)6 në raportin e saj të vitit 2012.

Agjencia e Statistikave e Kosovës e mat numrin e të punësuarve në institucionet publike të kulturës. Por Kosova nuk ka fare të dhëna për numrin e të punësuarve në institucionet e pavarura të kulturës, sikurse nuk ka statistika as për numrin e artistëve të pavarur në vend.

Me gjithë përpjekjet, që nga viti 2011, me angazhimin edhe të kryeministrit të atëhershëm, Hashim Thaçi, nuk është kryer ende çështja e statusit të punonjësve të kulturës. Së fundi “një peticion me 33 nënshkrime, ministrit të Kulturës, Kujtim Shala, i ka mbërritur në zyrë, ku punonjësit e Muzeut të Kosovës e kanë dërguar bashkë me kërkesën për zbatimin e Rregullores për gradimin dhe pagat e krijuesve dhe performuesve të kulturës dhe punonjësve profesionistë të trashëgimisë kulturore”. [Koha Ditore, 20 janar 2015].

IV. Një aspekt tjetër i rëndësishëm shumë i statistikave të kulturës lidhet edhe me aspektin ekonomik. Konkretisht, sa mund të gjenerojë mjete një [6 http://ec.europa.eu/culture/library/reports/ess-net-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/culture/library/reports/ess-net-report_en.pdf)

institucion i caktuar nga “shitja” e produktit kulturor.

Bazuar në Ligjin për Buxhetin për vitin 2015/7, në përgjithësi për kulturën nga kuleta e shtetit janë ndarë 6,538,736 euro. Prej tyre shteti projektonte që vetëm 32 mijë euro t’i rikthehen, meqë kaq mjetet ka parashikuar si investime në kulturë nën kodin “Të hyrat vetanake”. Pjesën tjetër, 6,506,616 janë paraparë si grant qeveritar. Interesant është fakti se përderisa shteti parashikon që në vitin e ardhshëm të rritë përkrahjen buxhetore për kulturën, përkatësisht 7,438,736 në vitin 2016 e ta zvogëlojë atë sërish në vitin pasues, 6,938,736 në vitin 2017, në të dy vitet pasuese parashikon të mbajë të njëjtin nivel të kthimit në investim. Pra parashikon të hyra vetanake nga 32,120 euro për tri vitet e ardhshme. Ato mëton t’i marrë, 17 mijë nga “përkrahja e institucioneve të kulturës”, ku investimi është në afër 4.7 milionë euro, ndërsa 15,200 euro të tjera nga Biblioteka Kombëtare, për mbajtjen e së cilës investon më shumë se 665 mijë

---

7 LIGJ PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2015 - <https://mf.rks.gov.net/sq-al/>

euro në vit.

Kjo tregon se sa pak rëndësi i kushton shteti me politikat e veta gjenerimit të mjeteve nga ana e shitjes së produkteve kulturore.

Në anën tjetër, mbetet i lartë dallimi i investimit të shtetit në institucione publike të kulturës, në krahasim me ato të pavarura.

“Për qindja e subvencioneve që ndahen për institucione publike kulturore varion prej minimum 60 për qind deri në 98 për qind të të gjithë subvencioneve të ndara për aktivitete kulturore. Një diskriminim i tillë në subvencionim mbyllet ‘konkurrencën’ në ‘tregun’ e kulturës dhe pengon zhvillimin e më tutjeshëm të kulturës”<sup>8</sup>.

Kjo e dhënë u vërtetua edhe në Fokus Grupin e mbajtur në qershor. Aty, Sali Shoshi tha se kultura duhet të jetë gjenerues i të hyrave shtetërore, dhe se MKRS nuk e ka trajtuar idenë e krijimit të ekonomisë përmes potencialeve që i ka.

“Në një vend normal, institucioni i cili nuk gjeneron të hyra do të duhet të mbyllet, sikurse edhe performanca e menaxherit të atij institucioni do të matej me biznes plan. Pra kultura ende është barrë. Ka mundësi që objektet e trashëgimisë të vihen në funksion për mbajtjen e konferencave dhe ekspozitave të ndryshme, dhe në këtë mënyrë të gjenerohen të hyra”, ka thënë Shoshi. “Unë, ta zëmë, fëmijën tim nuk mund ta dërgojë në një muze në të cilin nuk ndodh asgjë ose atje ku një ciceron flet me gjuhën që zor se një i rritur e kupton, por detyrohem ta dërgojë në një qendër tregtare”, ka shtuar ai.

Ndërkohë, pjesë e statistikave janë edhe çmimi i shërbimeve kulturore. Në raportin e “Eurostat Pocketbook – Cultural Statistics”, për vendet evropiane, përfshihen CD-të, filmat e librat . Sa për krahasim, Agjencia e Statistikave e Kosovës në asnjë vend nuk i përmend çmimet e biletave në kinema, teatër apo çmimet e librave. Duhet kujtuar se për të parë ekspozitat e muzeve apo të galerive të arteve në Kosovë nuk duhet fare pagesë.

---

<sup>8</sup> [http://ëëë.forumikulturor.net/repository/docs/Politikat\\_kulturore\\_dhe\\_Ndarja\\_buxhetore\\_per\\_kulturen.pdf](http://ëëë.forumikulturor.net/repository/docs/Politikat_kulturore_dhe_Ndarja_buxhetore_per_kulturen.pdf)

V. Gjithnjë duke u bazuar në shembullin se si Evropa i mat statistikat (“Eurostat Pocketbook – Cultural Statistics”), vërejmë se Kosova nuk ka fare informata të grumbulluara as për importin e të mirave të kulturës e as për eksportin eventual. Pra, nuk kemi në një vend numrin e librave, gazetave e revistave, CD-ve e DVD-ve (të muzikës e të filmit por me të drejta autoriale), që hyjnë në Kosovë. Nuk matet as numri i instrumenteve muzikore, as i mjeteve për prodhimin e artit pamor.

Nga ana tjetër nuk ka statistika as për të mirat e kulturës eventualisht të eksportuara jashtë vendit. Nuk matet se sa libra, gazeta e revista, albume muzikore ose prodhime filmike kanë dalë nga Kosova për në vendet të ndryshme të rajonit a më gjerë. Kosova s’është që prodhon ndonjë instrument muzikor. Megjithatë, okarina – instrumenti më i vjetër që u gjet në Kosovë, në Runikë të Skenderajt, e origjinali i të cilit ndodhet ende në Beograd si pjesë e thesarit të cilin Serbia e mori nga Kosova kur u largua me ushtri e administratë në vitin 1999 – prodhohet nga Shaqir Hoti. Biznesin e tij shteti do të duhej ta merrte nën mbrojtje e prodhimet të

dilnin edhe në tregun e huaj si brend i shtetit më të ri në Evropë. Matja e njësisve që do të dilnin jashtë kufijve të vendit do të duhej të ishin subjekt i matjes së “statistikave kulturore”. Në këto rrethana, është afër mendsh që instrumentet e tij kanë dalë jashtë kufijve të shtetit ose si dhurata ose të blera nga vet ndërkombëtarët, por ato nuk janë regjistruar askund.

VI. Tashmë është sfidë globale çështja e “rrezikut” që kulturës i kanoset nga teknologjia informative. Interneti në masë të madhe po ndryshon zakonin e konsumit të kulturës. Leximi i librave e gazeta të shtypura është trend në rënie, derisa shikimi i filmave në internet sikurse edhe vizita e pikave turistike përmes internetit po bëhen gjithnjë e më shumë atraktive.

Në këtë kontekst, matja e shprehive të konsumit të kulturës duhet ta ketë parasysh edhe këtë aspekt.

## 2. Shembulli i ASK-së [Çka bën (dobët) Kosova]

Për Agjencinë e Statistikave të Kosovës kultura ndodh vetëm në institucionet shtetërore të kulturës. Ata që përcjellin produkte kulturore në institucionet e pavarura të kulturës nuk paraqesin “numra” në statistikat e kësaj Agjencie. Ata nuk regjistrohen nga Agjencia shtetërore që ka për obligim ta bëjë këtë gjë.

Kjo qasje, që mund të jetë edhe lëshim profesional, tregon për një joseriozitet të kësaj Agjencie, derisa mëton se nxjerr një raport statistikor të kulturës në vend.

Raporti për statistikat kulturore nuk tregon se me çfarë metodologjie punon. Pra, aty nuk kemi informacion se si mbledhen informatat dhe nuk kemi një qasje të qartë se cilët numra i konsideron më të rëndësishëm ASK-ja në raport me prodhimet kulturore në vend. Krejt çka mund të nxirret në këtë kontekst janë disa fjali të parathënies së botimit, ku tregohet se burim i të dhënave për statistikat e kulturës janë Drejtoratet e Kulturës Rinisë dhe Sportit në nivele komunale. Në bisedën për këtë raport, Naime Rexhepi, shefe e Divizionit të Statistikave Sociale tregon

se si bëhet mbledhja e informatave. “Fillimisht bëhet dizajnimi i pyetësorit të kulturës, mandej shpërndarja e pyetësorëve në teren (përmes zyrave regionale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës - ASK të cilat iu shpërndajnë Drejtorive komunale për kulturë dhe sport) dhe caktohet një afat kohor për plotësim prej 15 ditësh. Pyetësorët e plotësuar i sjellin në ASK stafi i zyrave regionale. Bëhet kontrollimi logjik i secilit pyetësor – përpunimi dhe analizimi i të dhënave dhe si raport vjetor publikohet në ueb faqen e ASK”<sup>9</sup>. Ajo tregon se “të dhënat e grumbulluara përpunohen, analizohen si dhe bëhet krahasimi me vitin paraprak dhe në rast se kemi ndonjë lëvizje të madhe të numrit të shfaqjeve, numrit të shikuesve etj. atëherë kontaktohen institucionet përkatëse për sqarime të mëtutjeshme. Vetëm pasi që të verifikohen të dhënat atëherë mund të vije deri te publikimi i tyre”<sup>10</sup>.

Publikimi përmban të dhëna statistike për vitin 2013, lidhur me aktivitetet kulturore të kinemave, teatrove, 9 Intervistë me Naime Rexhepi, shefe e Divizionit të Statistikave Sociale, 27 prill 2015

10 Po aty

galerive, muzeve, bibliotekave, baletit, filarmonisë si dhe përmban të dhëna për numrin e të punësuarve nëpër këto institucione. Për grumbullimin e të dhënave është shfrytëzuar pyetësoi i kulturës. [Statistikat e Kulturës, 2013, ASK]

Edhe në raport me Ministrinë e Kulturës, ky Agjencion ka një lëshim. Ani pse ka kohë që ky dikaster ka ndërruar emrin, konkretisht duke hequr “çështjet jorezidente” në detyrat e saj të punës, qysh në parathënie të raportit të vitit 2013 kjo Agjenci i referohet si Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve jorezidente. Në vend të Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

I gjithë raporti është vetëm 19 faqe.

I. Raporti nis me statistikat e Kinemasë. Duhet kujtuar se kinematë megjithatë nuk janë institucione shtetërore të kulturës. Kinemaja, si vendi ku shfaqen filma, janë biznese apo institucione të pavarura të kulturës.

Raporti nuk merret fare me Qendrën Kinematografike të Kosovës, i cili është institucioni shtetëror për shpërndarjen buxhetit për film. Ndër institucionet

vartëse të MKRS-së, ka primatin me buxhet. Atij në vitin 2013 i janë ndarë ..... euro. E në raportin e statistikave të po këtij viti ky institucion “nuk ekziston”.

Siç nuk ekziston as, ta zëmë, Festivali Ndërkombëtar i Filmit të Shkurtër dhe Dokumentar “Dokufest”, i cili ka marrë përmasa botërore. “Sipas statistikave të festivalit, rreth 10,000 vetë kanë marrë pjesë në edicionin e viti 2013 të festivalit, ku 23% nga gjithsej numri i mysafirëve ishin vizitorë të huaj. 40 Hulumtimi i kryer nga Instituti GAP gjatë edicionit të dhjetë të këtij festivali (2011) tregon që ndikimi ekonomik i Dokufestit në BPV-në ishte €3.1 milionë, gjersa ky numër pritet të jetë €21.9 milionë gjatë periudhës së ardhshme katërvjeçare. 41 Përfitues të drejtpërdrejtë të këtij festivali në qytet ishin bizneset, si baret, hotelet, restorantet, si dhe agjencitë turistike, bankat dhe kompanitë e telekomunikimit”<sup>11</sup>.

Sikurse për “Dokufest”, Agjencia e Statistikave e Kosovës nuk mat shi-  
11 [http://www.mti-ks.org/repository/docs/Profili\\_i\\_sektorit\\_te\\_turizmit\\_441471.pdf](http://www.mti-ks.org/repository/docs/Profili_i_sektorit_te_turizmit_441471.pdf)

kueshmërinë, rrjedhimisht edhe peshën, e festivaleve të tjera të filmit në Kosovë. Nuk tregon pra se sa shikues ka “PriFilmFest-i”, Festivali i Studentëve për Film dhe Teatër “Skena UP”, “Hyjnesha në fron”, “Nine Eleven”, “Shqip Film Fest”, e festivale të tjera.

Pra, ajo që tregon Agjencia e Statistikave të Kosovës, në pjesën për kinematë është një tabelë shabllon që numëron sa kinema janë në Kosovë, sa salla të kinemave, sa është numri i ulëseve, sa është numri i filmave të shfaqur për një vit, sa prej tyre janë të huaj e sa të vendit, numri i termineve në ditë, si dhe numri i shikuesve brenda një viti në të gjitha kinematë ekzistuese. Për ASK-në, informatë me interes del të jetë edhe numri i të punësuarve në këto kinema, duke krahasuar mbi baza gjinore.

Megjithatë, pos kësaj tabele dhe dy grafikoneve – njëri për përqindjen e filmave të huaj dhe atyre vendorë të shfaqur në kinema, dhe tjetri për të punësuarit në kinema në baza gjinore – nuk ka gjë tjetër.

Nëse vlerësohen estetikisht, këto tabella e grafikone nuk duken aspak bukur

dhe janë larg modeleve të reja që përdoren në raporte ndërkombëtare statistikore. Por më e rëndësishme se kaq, aty mungon një analizë, qoftë edhe elementare për këto statistika. Pra, ASK-ja mjaftohet me paraqitjen e tyre, por nuk tregon ta zëmë si është e mundur që në Deçan, nuk ka kinema, rrjedhimisht as numër të sallave e as të ulëseve, por në vitin 2013 janë shfaqur dy filma, një i huaj e një vendor, të cilët i kanë parë fiks 400 persona (siç!). Pa kinema, edhe në Gjakovë qenë shfaqur dy filma, të dytë të vendit, të cilët i kanë parë prapë numër fiks shikuesish, 500 persona. Sikurse në Fushë Kosovë, (dy filma të huaj për 250 shikues), në Kamenicë (12 filma, 10 të huaj e 2 të vendit, për 1345 shikues), në Mitrovicë (1 film i huaj për 343 shikues), në Lipjan (8 filma, 2 të huaj e 6 vendorë, për 710 shikues), ose statistika të përafërta edhe për qytetet Rahovec, Podujevë, Skënderaj, Ferizaj, Vushtrri, Malishevë e Graçanicë. [ASK, Statistikat e Kulturës 2013, fq. 5]

Laureta Haziri, zyrtarja e ASK-së e cila ishte e pranishme në Fokus Grupin e qershorit, ka theksuar se shumica e qyteteve ushtrojnë aktivitete kulturore

në Shtëpitë e tyre të Kulturës.

“Në vitit 2012 në publikimin e statistikave të kulturës është cekur me një fusnotë se Prishtina dhe Peja e kanë nga një kinema, ndërsa komunat e tjera aktivitetin e vet e ushtrojnë nëpër Shtëpitë e Kulturës”, ka thënë ajo.

Duke munguar analiza përmbajtjesore e këtyre numrave, mungon përgjigjja në pyetjen logjike që do të mund të shtrohej. Si është e mundur që në një qytet nuk ka kinema por ka shfaqje filmi për publikun? Ku u shfaqën këta filma dhe a u respektuan dispozitat ligjore që dalin edhe nga Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërt, për shfaqjet publike? [Shih: Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, 2004, Neni 29: E drejta e paraqitjes publike]

II. Në pjesën e statistikave për teatër, që në raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës nisin nga faqja 7, që në pamje të parë vërehet një diskrepancë me Ligjin për Teatrot. Ndonëse ky Ligj u miratua në Kuvendin e Kosovës në vitin 2011 (i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, 2012), madje si amandamentuar nga ai i vitit 2005, ASK-ja nuk e ka parë të ud-

hës të përshtatë termat e saj me këtë ligj.

Ta zëmë, që në fillim të këtij Ligji, Neni 3, kur flet për përkufizimet thuhet se “Teatri është institucion kulturor publik ose privat që merret me përgatitjen, organizimin dhe realizimin e shfaqjeve teatrore dhe shfaqjeve tjera skenike”.

Në Nenin pasues, 4, që flet për themelimin e teatrove, thuhet qartë se “Teatrot në Republikën e Kosovës themelohen nga personat fizikë dhe juridikë dhe kanë status publik apo privat; Teatrot kombëtare themelohen me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës me propozimin e Qeverisë; Teatrot e qyteteve themelohen me vendim të Asamblesë komunale. Komuna nuk mund të themelojë më shumë se një teatër të qytetit me status publik; Teatrot private, trupat teatrore, kompanitë teatrore dhe shoqatat teatrore mund të themelohen nga persona fizikë dhe juridikë vendorë apo të huaj në pajtim me këtë ligj dhe legjislationin në fuqi”. [Shih: Ligji për teatrot, 2012, Kuvendi i Kosovës]

Sado që ky Ligj ka mangësi, dhe kjo është çështje tjetër analize, megjithatë

ky Ligj e njej Teatrin edhe si institucion në pronësi private. Gjë të cilën nuk e bën Agjencia e Statistikave e Kosovës. Për të teatër nuk ndodh në institucione të pavarura të kulturës. Në këtë kontekst, është me interes një shembull ilustrues, që shfaqja që mban rekordin e shikueshmërisë në Kosovë, është “Tre gjermantë e trashë II”, prodhim i Teatrit ODA, i shfaqur 68 herë, për 10.720 shikues.

Për t’iu kthyer edhe njëherë Ligjit, Agjencia i ka të pakoordinuara termat për teatrot, edhe kur bëhet fjalë për ato publike. Neni 5 i Ligjit njuh Teatrot me status publik si: Teatrot kombëtare; Teatri i qytetit; Teatri i studentëve të fakultetit të arteve të Universitetit të Prishtinës. [Ligji për teatrot, Neni 5]

E ASK-ja i kategorizon teatrot në aso “kombëtare profesionale”, “teatrot amatore” dhe “teatrot e fëmijëve”.

Shablloni është i gatshëm. Informatat që merren nga Ministria e Kulturës, Rinisë e Sportit dhe prej Drejtorive të Kulturës në Komunat përkatëse, matin në një vend se sa është “numri i teatrove”, “numri i ulëseve”, “numri i shfaqjeve teatrale”, “numri i reprizave”, madje po

aty grumbullohen edhe “numri i shfaqjeve të koncerteve”, “numri i shfaqjeve të baletit”.

Në tabelat, që kanë dizajnin e njëjtë me ato të statistikave për kinema, matet edhe numri i shikuesve. Mbase vlen të përmendet se në vitin 2013, sipas ASK-së, në teatër kanë shkuar 124,062 shikues.

Është zor të merret për bazë kjo shifër për të analizuar shprehinë e kosovarëve për të vizituar teatrin. Nga kjo dalin dy sfida, njëra që flet se numri i personave që ndjekin shfaqjet teatrore është më i vogël se kaq e tjetra për të kundërtën e kësaj. Sa i përket të parës, nuk mund të thuhet se numri prej 124,062 shikuesve përkthehet automatikisht në po kaq persona, meqë nuk përjashtohen rastet kur një person shkon në secilën shfaqje teatrore të qytetit të tij. Ana tjetër e medaljes, ajo që u tha edhe më parë, është se Agjencia nuk matë numrin e ndjekësve në institucionet jopublike si dhe ato të festivaleve (“SkenaUP”, Festalet e Qyteteve: Gjilan, Ferizaj, e të tjerë).

Numri 124,062 shikues (sipas statistikave të vitit 2013) e ka edhe një tjetër



problem serioz. Ky numër përthekon në një vend shikuesit edhe të shfaqjeve teatrale, premiera dhe repriza, edhe ata të shfaqjeve të koncerteve, si dhe ata të shfaqjeve të baletit. Pra, ne nuk dimë saktësisht se sa shikues kanë shkuar në teatër për të parë një shfaqje teatri, e sa të tjerë kanë shkuar aty për të ndjekur një koncert apo për të parë një shfaqje baleti. Bazuar në raportin e vitit 2013, ne dimë vetëm se “teatrot kombëtare profesionale” kanë dhënë 35 shfaqje teatrale dhe 227 repriza të tyre, 4 shfaqje baleti, ndërsa kanë shfaqur 34 koncerte. Në “teatrot amatore” janë dhënë 87 shfaqje teatri me 249 repriza të tyre, 13 shfaqje të baletit, ndërsa janë shfaqur aty edhe 125 koncerte. Në teatrot për fëmijë, janë shfaqur 11 shfaqje me 227 repriza të tjera dhe katër shfaqje baleti. Asnjë koncert. Në teatrot për fëmijë (dy sosh, një në Prishtinë dhe një në Kamenicë) ka pasur 28,788 shikues, në ato amatore (22 sosh) 52,195 shikues ndërsa në teatrot kombëtare profesionale (5 sosh) ka pasur 43,079 shikues, gjithnjë bazuar në statistikat e 2013. Në këto teatro, sipas ASK-së punojnë 193 persona, ndërsa prej tyre 52 janë gra.

III. Baleti Kombëtar i Kosovës, që veprimtarinë e ushtron nën kulmin e Teatrit Kombëtar të Kosovës, gjatë vitit 2013 ka dhënë 4 premiera, të cilat i ka reprizuar edhe 50 herë të tjera. E në mesin e vitit që zë 320 vende, i bie që mesatarisht secilën shfaqje të baletit e kanë parë nga 212 shikues. Me një tabelë me këta numra, të pa analizuar, e përmbyll ASK-ja raportin për BKK-në.

Ndërsa më pak se kaq të dhëna ka për Filarmoninë e Kosovës, që bashkë me Baletin zënë vend në faqen e fundit të raportit statistikor. Krejt çka tregohet për këtë institucion është se në vitin 2013, ai dha 24 koncerte me Orkestër, 7 me Kor, pra gjithsej 31. Dy koncerte të tjera janë dhënë jashtë vendit. Numri i shikuesve aty nuk paraqitet.

IV. Galeritë e artit janë të tretat në radhë për të cilat ASK-ja tenton të marrë statistika. Problemet përsëriten. Zyrtarisht vetëm në Prishtinë janë dy Galeri dhe një tjetër në Pejë. Por ASK-ja ka regjistruar në Deçan (6 ekspozita për 300 vizitorë), në Gjakovë (5 ekspozita për 300 vizitorë), në Glogoc (4 ekspozita për 500 vizitorë), në Istog (4 ekspozita për 1,000 vizitë), në

Klinë (3 ekspozita 650 vizitorë), Fushë Kosova (5 - 600), Kamenica (4 - 320), Mitrovica (9 - 2,676), Rahoveci (20 - 400), Podujeva (6 - 1700), Skënderaj (3 - 350), Suhareka (10 - 900), Ferizaj (9 - 2,676), Vitia (6 - 1000), Vushtrria (8 - 480), Malisheva (4 - 150) dhe Graçanica (11 ekspozita për 1,000 vizitorë).

Në Galerinë në qytetin e Pejës janë çelur 17 ekspozita për 2,700 vizitorë, ndërsa në dy galeritë në Prishtinë, Galerinë Kombëtare të Arteve dhe Galerinë e Ministrisë së Kulturës “Qafa”, janë çelur 30 ekspozita për 11,588 vizitorë.

Gjithsej, i bie që në vitin 2013, nëpër këto qytete të Kosovës, janë çelur 176 ekspozita, ndërsa kanë qenë për t’i parë ato 30,290 vizitorë.

Nuk kemi fakte “për të akuzuar” për pasaktësi apo për mungesë besimi në këto të dhëna. Megjithatë, kemi dyshime të forta për të konkluduar një gjë të tillë. 1. Ta zëmë, si është e mundur që shumica e këtyre institucioneve të artit pamor të kenë pasur numër fiks të vizitorëve. Çështja është si numërohen ata? Madje, pasaktësia logjike që del nga raporti i ASK-së, është se si

numërohen kur aty nuk raportohet fare për të punësuar!? Pra dyshimi është se raportimi i Drejtorive përkatëse të komunave për numrin e vizitorëve bëhet me metodën e hamendësimit. Dhe ASK-ja nuk ka mekanizma për verifikimin e informatave të tilla, dhe vendos që t’iu besojë symbyllurazi.

2. Duhet të jetë o gabim (i pafalshëm për një institucion serioz shtetëror) o rastësi në kufi të mrekullisë që dy qytete të kenë numër të njëjtë të ekspozitave dhe numër të njëjtë të vizitorëve, që në këtë rast nuk është fiks. Ferizaj dhe Mitrovica, në vitin 2013, sipas ASK-së, kanë çelur nga 9 ekspozita dhe kanë numëruar njësoj vizitor, saktësisht nga 2,676 vizitorë secila. Sa për krahasim, në vitin paraprak, pra atë 2012, ASK-ja raportonte për 2400 vizitorë në Mitrovicë dhe 5000 mijë në Ferizaj. Të dyja kishin çelur atë vit nga 10 ekspozita. [ASK, Statistikat e kulturës 2012, fq. 13]

3. Duke shmangur çdo paragjykim, shtrohet pyetja si ka mundësi që Istogu, me dyfish më pak banorë se Gjilani, të organizojë dyfish më pak ekspozita se ky Gjilani, e të grumbullojë gati dyfish më shumë vizitorë. Statistikat, sipas

ASK-së janë kështu: Istogu ka realizuar 4 ekspozita, dhe secilën prej tyre mesatarisht e kanë parë nga 250 vetë (1,000 vizitorë), ndërsa Gjilani organizoi hapjen e 8 ekspozitave për të cilat shkuan për t'i parë vetëm 600 vizitorë. Kujtojmë, se në vlerësimet e popullsisë për vitin 2013, po me burim ASK-në, Gjilani ka 91,489 banorë e Istogu 40,126.

Sipas raportit të ASK-së, mesatarisht një ekspozitë e kanë parë 172 vizitorë. Sado që kjo duket informatë relevante, do të ishte mirë statistikën të ndahen veç e veç për institucionet e kulturës. Në këtë kontekst, është mëse e nevojshme që ASK-ja të mbledh të dhënat edhe për institucionet e pavarura të kulturës. Vetëm në Prishtinë, janë disa galeri arti, për të cilat ASK-ja nuk kurrfarë informatash. Qendra për Art Bashkëkohor "Stacion", Galeria "Qahili", "Lambdalambdalambda", e të tjera.

V. Kosova nuk ka ende një Ligj të veçantë për muzetë, dhe ky është një proces i gjatë që ka prekur shumicën e kabinetëve të Ministrisë së Kulturës gjatë këtyre 15 vjetëve të pasluftës. Mbetet e paqartë çështja e themelimit të muzeve. Numri fiks i vizitorëve

përsëritet edhe tek muzetë. Rekordin vazhdimisht e mbanë kompleksi memorial i Jasharajve në Prekaz. Në Skenderaj, në një muze dhe në 4 shtëpi muze, në vitin 2013, ASK ka regjistruar 30 mijë vizitorë.

ASK-ja, për muzetë mat numrin e vizitorëve për institucionet muzeore në një shtyllë, dhe për shtëpitë muze në një shtyllë tjetër. Nga leximi i thjeshtë i numrave dalin disa analogji interesante.

Kësisoj, Prishtina si kryeqytet, ka të regjistruar një Muze, dhe në vitin 2013 sipas ASK-së, mblodhi 4560 vizitorë. Këtu hyjnë vizitorët e Muzeut të Kosovës, Muzeut Etnologjik dhe Shtëpisë së Pavarësisë. Në krahasim me këtë, Klina, ta zëmë, me vetëm një shtëpi muze ka raportuar e ASK ka publikuar numrin prej 5,000 mijë vizitorësh.

Më shumë se Prishtina, gjithnjë sipas raportit të ASK-së, vizitorë kanë edhe Deçani, që me një muze dhe 11 shtëpi muze ka raportuar 5,800 vizitorë, si dhe Ferizaj, që me një muze dhe 5 shtëpi muze ka raportuar më 2013, 5,357 vizitorë.

Një shtëpi muze në Podujevë, është raportuar të jetë vizituar fiks nga 2000 vizitorë, sa ka raportuar edhe qyteti antik i Prizrenit me Muzeun e Qytetit dhe 3 shtëpi muze. Përgjysmë më pak se Podujeva, janë regjistruar edhe te Muzeu i Pejës, një prej qyteteve po ashtu të mëdha. Nga 1,000 vizitorë, sa në muzeun e Pejës, janë raportuar edhe për muzeun në Junik, si dhe një muze e një shtëpi muze në Vushtrri.

Më shumë se në secilën fushë tjetër, ASK-ja këtu do të duhej të konkretizonte pyetjet në pyetësorin për MKRS-në dhe Komunat, në mënyrë që të dijë saktë se sa vizitorë ka secili muze apo shtëpi muze, që në këtë rast mund të jetë në pronësi private. Në anën tjetër, vetë institucionet shtetërore, duhet kërkuar mekanizma për matjen e numrit të vizitorëve jo vetëm në muze e shtëpi muze, por edhe në pika të tjera arkeologjike e turistike në qytete të caktuara.

VI. Duket se statistikat më të sakta ASK-ja i ka për bibliotekat. Këtu vlen të përmendet fakti se në të gjitha qytetet ku ka të dhëna, janë regjistruar 1,521,892 libra, në 106 biblioteka, të cilat i

frekuentojnë 170,001 lexues. Këtu numri i lexuesve nuk është fiks, meqë regjistrimi i tyre është i domosdoshëm nga vetë institucionet përkatëse.

Dallim i madh vërehet mes kryeqytetit dhe qyteteve tjera. Prishtina, në 15 biblioteka ka të regjistruar 132,348 lexues, duke qenë e vetmja jo vetëm me numër 6 shifror, por as një qytet tjetër nuk arrin numrin 5 shifror të lexuesve. Gjilani ka të regjistruar 4,829 lexues, Ferizaj - 3,977, Gjakova - 3,460, Prizreni - 3,267, Shtimja - 3,062, Podujeva - 2,365, Mitrovica – 933 lexues, e të tjerë.

Megjithatë mungon analiza përmbajtësore e këtyre numrave, nëse këta lexues janë aktivë, apo thjeshtë janë të regjistruar në këto biblioteka.

# 3. Intervista

Përkundër kësaj, Naime Rexhepi, shefe e Divizionit të Statistikave Sociale, është e bindur se “shfrytëzues kryesor i të dhënave të kulturës është Ministria e Kulturës dhe Sportit si dhe institucionet tjera qeveritare dhe joqeveritare”<sup>12</sup>.

Por Shkëlzen Dragaj, që ka qenë zëdhënës në Ministrinë e Kulturës në vitin 2013, thotë se në kohën sa ministër kulture ka qenë Memli Krasniqi, nuk i janë referuar shpesh statistikave të ASK-së.

“Sepse edhe në ato raste kur ka pasur kanë qenë të pakta dhe të mangëta dhe me pasaktësi shpesh. Kryesisht ne politikat i kemi bazuar në konsultim me komunitetin, përfaqësuesit e shoqatave të ndryshme dhe grupet e ministrisë, gjithnjë edhe duke marrë modele nga vende të ndryshme dhe përvoja nga viti në vit”<sup>13</sup>.

Rexhepi thotë se “synim i ASK-së, përkatësisht Departamentit të Statistikave

---

12 Intervistë me Naime Rexhepi, shefe e Divizionit të Statistikave Sociale, 27 prill 2015

13 Intervistë me Shkëlzen Dragajn, ish zëdhënës në MKRS, 12 maj 2015

Sociale është rritja e kualitetit të të dhënave si dhe zgjerimi me tregues të ri të kulturës. Qëllimi i ASK përkatësisht Departamentit të Statistikave Sociale është që institucioneve vendimarrëse t’u ofrohen informacione lidhur me aktivitetet kulturore të zhvilluara në vend”<sup>14</sup>.

Rexhepi ka thënë se me raportin janë të kënaqur.

“Jemi të kënaqur me punën që bëjmë dhe po ashtu të kënaqur me cilësinë e raportit. Mirëpo ne synojmë rritjen e kualitetit të të dhënave në vazhdimësi”<sup>15</sup>.

Shefja e Divizionit të Statistikave Sociale thotë se të dhënat për aktivitetet kulturore që ASK i ofron janë të dhëna të cilat merren nga institucionet e licencuara të kulturës.

“Shpresojmë që në të ardhmen të ofrojmë të dhëna edhe për institucionet e pavarura të kulturës në mënyrë që raporti ynë të jetë sa më gjithëpërf-

---

14 Intervistë me Naime Rexhepi, shefe e Divizionit të Statistikave Sociale, 27 prill 2015

15 Po aty

shirës”<sup>16</sup>.

Në anën tjetër, Vehbi Miftari, zëdhënës aktual në Ministrinë e Kulturës, ka thënë shkurt se do të mbesin në kontakt me Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

# REKOMANDIMET

- Institucionet e kulturës në vend duhet të punojnë në krijimin e një mekanizmi të gjenerimit të statistikave në kulturë.
- Agjensioni i Statistikave të Kosovës duhet të qartësojë metodologjinë e punës sikurse që duhet të punojë në krijimin e një sistemi të besueshëm matës dhe raportues.
- Agjensioni i Statistikave të Kosovës rekomandohet të bazohet në përvojat e mira të Raportit të Eurostatit mbi “Statistikat Kulturore”, duke përfshirë marrjen në shqyrtim të demografisë, indeksit kulturor, institucioneve të pavarura të kulturës, shifrave të eksportit dhe importit, etj.
- Institucionet e kulturës duhet t’i kushtojnë rëndësi statistikave të kulturës me qëllim të planifikimit më të mirë të politikave kulturore.
- Statistikat për institucione të kulturës të shërbejnë edhe për matjen e performancës së vet atyre institucioneve kulturore dhe menaxhmentit të tyre.
- Agjensioni i Statistikave të Kosovës duhet të standardizojë raportimin me ligjet që janë në fuqi, praktikisht të bëjë kategorizimin dhe emërtimin e institucioneve të kulturës bazuar në legjislacionin në vend (rasti i Ligjit për Teatro).
- Në statistikat për kulturë është e rëndësishme të përfshihen edhe institucionet e pavarura të kulturës dhe individët të cilën operojnë në mënyrë të pavarur në sektorin e kulturës.
- Statistikat e kulturës rekomandohet të raportojnë mbi eksportin dhe importin e produkteve kulturore me qëllim të promovimit të gjenerimit të hyrave përmes shitjes së produktit kulturor.
- Agjensioni i Statistikave të Kosovës rekomandohet që të raportojë edhe për çmimet e biletave hyrëse për aktivitete të caktuara në institucionet kulturore.
- Agjensioni i Statistikave të Kosovës rekomandohet që të ndërtojë një sistem të verifikimit të informatave të marra nga zyrtarët komunalë me qëllim të ndërtimit të një raportimi të besueshëm.

- Në rastin e raportimit me parregullsi nga zyrtarët komunalë (shifra të përsëritshme, jo korrespondente me numrin e aktiviteteve etj.), Agjensioni i Statistikave të Kosovës rekomandohet të analizojë të dhënat dhe të raportojë mbi pasaktësinë e tyre.
- Të gjitha institucionet e kulturës rekomandohet të ideojnë një mundësi për matjen e vizitorëve, përmes një punonjësi të angazhuar enkas për numërimin e tyre, përmes lëshimit të listës së pjesëmarrësve apo përmes dhënies së biletave hyrëse edhe në rastet kur hyrja është e lirë (pa pagesë) me qëllim të arritjes së shifrave për raportim.
- Institucionet e përfshira në promovimin e trashëgimisë së kulturës rekomandohet të prodhojnë më shumë aktivitete dhe mundësi shfrytëzimi, pra të punohet në menaxhimin e objekteve kulturore, në mënyrë që të ketë më shumë vizitorë, e rrjedhimisht më shumë shifra të raportuara në fundvit.
- Rekomandohet që të raportohet sa më shumë për numrin e vizitorëve në lokalitetet dhe objektet e trashëgimisë kulturore, me qëllim të promovimit sa

më të madh të tyre.





Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë



Implementuar nga:



[www.forumikulturor.net](http://www.forumikulturor.net)



*forumikulturor.net*  
*facebook.com/ForumiKulturor*  
*twitter.com/forumikulturor*